# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-440026**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama flet për takimin në Berat: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit i dha shije debatit - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/rama-flet-per-takimin-ne-berat-kokefortesia-kolektive-e-policanit-i-dha-shije-debatit/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 15:53:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 15:40:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `982fe8af7beb1145183a9102c790a862e29e51490b3f73ea173e536c41381f9a` |
| TEKSTI | `f625864e319a79fa8463a3a7f7cbc7cb8da5a808f7080f83c92505cf8d9e0347` |
| PAMJA | `dfdaf5dc38b9a20f399c91c7cf34381d87e1a88baf0e302a4f7cef6a8208df98` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a25beab4c2e34280b3d27bbbbc34dd93bebe7e2f88489e8497cec70cde5c6b80` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b8dae6c54853da1d85da2cfc2b078041a9e4d965e832e711de05f684850346bc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a25beab4c2e34280b3d27bbbbc34dd93bebe7e2f88489e8497cec70cde5c6b80`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

# Rama flet për takimin në Berat: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit i dha shije debatit

LAJMI I FUNDIT

17:30 Ministri iranian i Mbrojtjes: Jemi gati për më shumë luftime, kemi zbuluar disa nga aftësitë tona mbrojtëse

17:16 Një person futet në shtëpinë e Kamala Harris në Kaliforni, ndërhyn personeli i sigurisë

17:05 Policia turk bastis bare dhe shtëpi të aktivistëve të komunitetit LGBTQ+, arrestohen 47 persona

16:53 "Apokalips teknologjik në 6 muaj", studiuesi i IA-së jep alarmin

16:51 Trump me mesazh për Zelensky-n: Ndaloni sulmet ndaj naftës ruse

16:31 Izraeli zgjeron operacionet ushtarake në Siri pavarësisht bisedimeve

13 Shtator 2026 | 17:40

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryeministri Edi Rama përmes një postimi në "Facebook" ka ndarë pamje nga takimi i zhvilluar këtë të diele në qytetin e Beratit. Ky takim erdhi në kuadër të takimeve që po zhvillon kryeministri për të folur dhe diskutuar lidhur me Reformën Terrioriale.

Ai theksoi se ky riorganizim nuk cenon ofrimin e shërbimeve në Poliçan, Dimal dhe njësitë e tjera, por synon një administrim më efikas dhe krijimin e mundësive më të mëdha për zhvillim dhe investime në territor.

"Më thoni çfarë mendoni ju se do të dëmtohet në rast se do të bëhet bashki. Kur më thua rruga, e më thua shërbimi, këto nuk ndryshojnë. Nuk do të ikin shërbimet nga Poliçani, nga Dimali ose nga askund. Përkundrazi, këto nuk ndryshojnë. Në raport me çfarë keni, ndryshon vetëm një gjë; nuk do të keni kryetar bashkie të zgjedhur.

Nuk ndryshon godina, nuk ndryshon stafi, nuk ndryshon numri i shërbimeve që bëhen, në kuptimin nuk ulet, se duhet shtuar. Ti thua distanca? Ça lidhje ka distanca? Ato shërbime që ti merr sot në Poliçan ose në Dimal, do t'i marrësh po aty. Pra, bashki, qytet, njësi administrative. Dhe qyteti Poliçan, qyteti Dimal do të kenë drejtuesin e tyre, do të kenë këshilltarët e tyre në Këshillin Bashkiak të bashkisë Berat, me kuota.

Më thoni dhe një gjë tjetër, komunat janë më mirë sot apo ishin më mirë kur ishin veç, se këto biseda unë i kam dëgjuar "mot a mot" në kohën e reformës 2015; "do na ikë kjo, do na ikë ajo; jo distanca; ohu, sa larg është Poliçani, ne jemi këtu te komuna jonë; sa larg është qendra e Urës, ne jemi te komuna jonë; ne kemi këtë, kemi atë, kemi kryetarin e komunës...

Ndodhi ndonjë gjë e kësaj natyre? A janë sot, a kanë marrë më shumë investime komunat se ç'bënin më përpara apo kanë marrë më pak? Investimet e komunave nga iu erdhën? Nga vetja? Iu erdhën nga bashkimi", u shpreh ai gjatë takimit.

TESTIM

Rama gjithashtu ka komentuar në postim edhe debatet të cilat u zhvilluan gjatë diskutimeve teksa shkruan se kokëfortësia e qytetarëve nga Poliçani dhe Dimali i dhanë takimit shijen e një ballafaqimi të posaçëm.

"Sot në Berat, ku kokëfortësia kolektive e Poliçanit dhe këmbëngulja e disa zonjave të mirëpërgatitura të Dimalit, i dhanë diskutimit shijen e një ballafaqimi të posaçëm", shkruan

mirëpërgatitura të Dimalit, i dhanë diskutimit shijen e një ballafaqimi të posaçëm", shkruan Rama në "Facebook".

Gjatë takimit përfaqësuesit e Poliçanit kanë kërkuar të marrin fjalën për të paraqitur problematikat që lidhen me zonën e tyre.

Gjatë diskutimit, situata është tensionuar pas një reagimi të Kryeministrit Rama ndaj pjesëmarrësve. Përplasja verbale është vijuar edhe me kryebashkiakun e Poliçanit, Adriatik Zotkaj, si dhe me aktoren Egla Ceno.

Debati ka bërë që përfaqësia e ardhur nga Poliçani të largohet nga salla, duke ndërprerë pjesëmarrjen në dëgjesën për Reformën Territoriale në shenjë proteste ndaj zhvillimit të takimit.

Debate të forta për "Territorialen", tensione mes Ramës dhe krybashkiakut të Poliçanit! Përfaqësuesit largohen nga takimi

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### Kërcënoi kushëririn për t'i marrë 300 mijë euro, arrestohet 56-vjeçari në Vorë

Një 56-vjeçar është arrestuar në Vorë, pasi dyshohet se ka kërcënuar kushëririn e tij dhe familjarët e tij për t'i marrë shumën prej 300 mijë...

12:45 | 13/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Ministri Nufi: Industria e mbrojtjes, prioritet strategjik për Shqipërinë

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi e cilëson zhvillimin e industrisë së mbrojtjes si një prioritet strategjik për Shqipërinë. Përmes një video-mesazhi, ai cilëson se vendi...

12:33 | 13/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Sekuestrohen 3 makina luksoze në Vlorë

Policia e Vlorës ka sekuestruar tre automjete luksoze, të prodhimit të viteve të fundit. Gjatë verifikimeve nga kontrollet e bëra, disa automjete u shoqëruan për kontroll të mëtejshëm....

11:51 | 13/09/2026

**Follow Euronews on all platforms:**

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.